



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha raportuese	Raport mujor, janar 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Drita Rudi dhe Valbona Gashi

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës për muajin janar 2016:

Kulturë:

- Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga drejtoria dhe Komuna. Janë ftuar drejtorë të festivaleve dhe shoqatave;
- Është përgatitur plani i punës për vitin 2016 i DKRS dhe institucioneve varëse;
- Përgatitja e listës së aktiviteteve kulturore;
- Janë zhvilluar dy takime me forumin kulturor, drejtor të festivaleve dhe OJQ-ve që veprojnë në komunë të Prishtinës;
- Është bërë përpjekje për përcaktimin e kritereve për nënshkrim të marrëveshjes mes Komunës së Prishtinës dhe festivaleve e organizatave që veprojnë në Prishtinë gjatë gjithë vitit;
- Në kalendarin kulturor në vazhdimësi regjistrohen aktivitetet e organizuara nga Komuna e Prishtinës dhe aktivitete për të cilat njoftohemi përmes shkresave dhe njoftimeve në media;
- Sa i përket çështjes gjinore, mbarëvajtja e përgjithshme e punës është realizuar me sukses, si takimet me palë, bashkëpunimi/konsultimet me organizata vendore dhe ndërkombëtare relevante, organizimi i takimeve, pjesëmarrjet, planifikimi për aktivitete etj.;
- Në teatrin e “Dodona”, është mbajtur takim dhe është vizituar teatri për projektimin e projektit për këtë ndërtesë për rekonstruktimin dhe klimatizimin në teatrin “Dodona”;
- Në teatrin “Dodona” janë zhvilluar një sërë aktiviteteve për realizimin e shfaqjeve të programit të rregullt, si dhe aktivitete përgatitore për realizimin e premierave të reja;
- Për periudhën raportuese, në teatrin “Dodona” janë planifikuar të realizohen shtatë (7) repriza të shfaqjeve nga repertori i Teatrit të Kukullave, si më poshtë:

- Janë planifikuar tri (3) repriza të shfaqjeve për të rritur. Është planifikuar pjesëmarrja në festivalin “ Flakët e Talisë” në Gjilan, më 26 janar 2016;
- Në muajin janar është planifikuar realizimi i një ekspozite të fotografisë së artistit Vigan Nuza;
- Provat e rregullta për shfaqjet e reja “Fustani pika-pika” për Teatrin e Kukullave, si dhe “ Më fol për dashurinë” për skenën për të rritur;
- Në kuadër të aktiviteteve dytësore, janë planifikuar edhe mbajtja e provimeve të Fakultetit të Arteve të Bukura, si formë bashkëpunimi mes teatrit dhe këtij fakulteti;
- Në Arkivin e qytetit janë përgjigjur në 78 kërkesa, ku janë pajisur palët me dokumentet e kërkuara;
- Arkivi ka përfunduar me rregullimin e materialin arkivor të Drejtorisë së Urbanizmit, njësitë organizative 02, 03, 06 dhe 14, dhe janë duke u përpiluar listat e brendshme, si dhe regjistri i lëndëve të rregulluara;
- Është filluar me ndarjen e materialit arkivorë të Avokaturës Publike të Komunës së Prishtinës nga viti 1963 - 1975;
- Nga ana e Arkivit është bërë vizitë në gjimnazin “Sami Frashëri”, me ç’rast u është dhënë propozimi për seleksionimin e lëndës arkivore. Pas punës njëjavore, është arritur që një pjesë e pavlefshme e kësaj lënde të asgjësohet;
- Krijimi i ueb-faqes së bibliotekës në Facebook;
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit, regjistrimi i anëtarëve të rinj, huazimi i librit dhe lidhja e gazetave, leximi dhe komentimi i librit, vizatime nga përmbajtja e librit, lojëra logjike, punë dore etj.;
- Përgatitja e raporteve vjetore për vitin 2015 dhe raporteve mujore;
- Promovimi i librit “Ibrahim Rugova”, bibliografi letrare 1961-2015, i autorit Munish Hyseni, drejtor i Bibliotekës.

Rini dhe Sport:

- Edhe këtë vit Sektori i sportit ka filluar me mbledhjen e informatave të klubeve sportive të kryeqytetit, ku ka formuluar një formular me pyetje të përgjithshme. Plotësimi i formularëve të sportit komunal nga ana e klubeve sportive publike, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e klubeve sportive që mban sektori ynë, është obligues, pasi që qëllimi i plotësimit të këtij formulari nga ana e tyre është që të njihemi me gjendjen aktuale të klubit, duke përfshirë informata të përgjithshme të klubit, ku ndër to janë vendi dhe koha e mbajtjes së stërvitjeve, niveli garues, numri i anëtarëve, trajnerët, gjithashtu edhe sjellja e raportit të punës së Kuvendit, procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit, me anë të të cilëve do të njoftohemi për punën, ndryshimet në kryesi, si dhe zhvillimet e klubit në përgjithësi. Për dallim nga vitet tjera, gjatë këtij viti klubet sportive kanë për obligim të sjellin listën e anëtarëve/sportistëve të licencuar dhe të vërtetuar nga federata përkatëse ose kopjet e kartelave të sportistëve të licencuar. Mbledhja e këtyre formularëve është duke vazhduar deri në javën e parë të muajit shkurt, ku me anë të këtyre informatave Sektori ynë do të mund të bëjë një selektim të klubeve sportive publike të përgjegjshme dhe të atyre të papërgjegjshme apo jo aktive.

- Pas ritenderimit të projektit “Pajisja e klubeve sportive të komunës së Prishtinës me rekuizita sportive”, për loton I dhe IV, më 20 janar është bërë vlerësimi i tenderit, ku për loton e parë kanë aplikuar tre ofertues (operatorë ekonomikë), mirëpo Komisioni për vlerësim ka konstatuar se asnjëri nga ofertuesit nuk i ka plotësuar kriteret, ndërsa për loton IV ka ofertuar vetëm një kompani. Në fillim të muajit shkurt, do të ritenderohet ky projekt.

- Pas ritenderimit të projekteve nga viti i kaluar për ndërtimin e këndeve të lodrave për fëmijë në lagjet “Dardania” dhe “Kodra e Diellit”, gjatë muajit janar të këtij viti, Komisioni për vlerësimin e këtij tenderi ka bërë përzgjedhjen e operatorit ekonomik të përgjegjshëm (fitues) OE “Aring”, i cila pritet që deri në fund të muajit janar ta nënshkruajë kontratën dhe të fillojë me punime.

Sa i përket tenderit për ndërtimin e këndeve të lodrave për fëmijë në lagjet “Kalabria” dhe “Kodra e Diellit”, është anuluar për shkak të disa sqarimeve të kërkuara nga ofertuesit ndaj kompanisë projektuese në përshkrimin e njërës nga pozicionet e paraqitura në tender. Pasi janë bërë sqarimet e nevojshme të këtij pozicioni nga kompania projektuese, është bërë ritenderimi i këtij projekti dhe hapja e ofertave do të bëhet më 15 shkurt 2016.

- Takim me përfaqësuesit e “Innovations Lab Kosovo”, që është program i UNICEF-it në Kosovë, i implementuar nga organizata joqeveritare "PEN"- “Peer Educators Network”, i cili do të mbajë një punëtori "UPSHIFT- Social Impact Workshop" për të rinjtë dhe të rejat në komunën e Prishtinës.

Laboratori për Inovacione në Kosovë organizon UPSHIFT: “Social Impact Workshop”, e cila është punëtori e modelit dinamik, që sjell së bashku idetë, problemet, të rinjtë, dhe metodat e ndryshme edukative dhe inovative për të zgjidhur probleme të ndryshme shoqërore.

Punëtorja e radhës “UPSHIFT Social Impact Workshop” do të organizohet në rajonin e Prishtinës dhe Fushë-Kosovës, më 5-7 shkurt 2016.

Punëtorja ka për qëllim inkurajimin e të rinjve nga këto vende për identifikimin e problemeve në shoqëri dhe zgjidhjen e tyre. Pas aplikimit do të selektohen dhjetë ekipet e përzgjedhura, që do të konkurrojnë për pesë çmimet e para, 3 ditë radhazi në punëtori, të cilat do të mbështeten në monitorim dhe financim për një periudhë 3 mujore pas punëtorisë, dhe në shumë deri 2.000 euro, për ta zhvilluar më tutje idenë dhe projektin e tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Aktivitetet e parapara sipas plan programit të Komunës për muajin raportues:

Kulturë:

- 21 janar – Dita e Arkivit të Komunës së Prishtinës.

Rini dhe Sport:

- Hartimi i planit të veprimit rinor lokal 2016-2018.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër:

Kulturë:

- Më 21 janar, Arkivi Komunal i Prishtinës shënoi 47-vjetorin e punës. Gjatë kësaj dite ishte dyert e hapura për qytetarë, për të mësuar për punën dhe funksionimin e këtij institucioni. Të pranishëm ishin edhe nxënësit e dy shkollave fillore të kryeqytetit “Elena Gjika “ dhe “Gjergj Fishta”;
- Teatri “Dodona” ka realizuar 7 repriza të shfaqjeve nga repertori i Teatrit të Kukullave;
- 4 repriza të shfaqjeve për të rritur (përfshirë një me pjesëmarrjen në festivalin “Talia e Flakës” në Gjilan, me 26 janar 2016;
- Në teatrin “Dodona” është realizuar ekspozita e fotografive të artistit Vigan Nuza;
- Janë mbajtur provat e dy premierave të teatrit “Dodona”: një për skenën për fëmijë dhe një për të rritur.

Rini dhe Sport:

- Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Sektori për rini dhe sport, ka iniciuar procedurat për hartimin e planit të veprimit rinor lokal 2016-2018.

Në vazhden e agjendës së punës rreth këtij plani, është organizuar punëtorja treditore me OJQ-të anëtare të KVRL-së dhe me këshillin e nxënësve të komunë së Prishtinës. Punëtorja është mbajtur më 25-26-27 janar 2016.

Në këtë punëtori u punua sipas këtij plani:

- Prezantimi i pikave të punëtorisë 3-ditore dhe prezantimi i pjesëmarrësve;
 - Prezantim i shkurtër i planit të veprimit rinor lokal të Komunës së Prishtinës 2013 -2015;
 - Diskutim për planin e veprimit rinor lokal 2013-2015: të arriturat, vështirësitë dhe dështimet;
 - Objektivat e planit të veprimit rinor lokal 2016-2018 (të bazuara në planin e veprimit rinor lokal 2013-2015);
 - Aktivitetet e planit të veprimit rinor lokal 2016-2018 (të bazuara në planin e veprimit rinor lokal 2013-2015);
 - Hartimi i projektplanit të veprimit rinor lokal 2016-2018, në formë tabelore;
 - Konkluzion dhe përmbyllje.
- Gjatë këtij muaji është realizuar takimi me Aleancën Franceze, ku diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit mes tyre dhe Komunës së Prishtinës. Përfaqësuesit e

Aleancës Franceze shprehën interesimin e tyre për të qenë pjesë, apo për të kontribuar në zbatimin e projekteve nga ana e të rinjve të komunës së Prishtinës.

Jemi informuam se projekti aktual në të cilin janë duke punuar në Aleancën Franceze, është mbajtja e kursit të gjuhës frënge për të rinjtë, fëmijët dhe të gjithë të interesuarit e tjerë shtetas të Kosovës. Në takimet e vazhdueshme që do t'i kemi me të rinjtë, ne do t'i informojmë për mbajtjen e kursit të gjuhës frënge.

Për ta konkretizuar bashkëpunimin, ne do të kemi takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Aleancës Franceze.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Aktivitetet që janë në implementim e sipër për muajin raportues.

Kulturë:

- Në përfundim të inventarizimit të objektit të ri të bibliotekës "Hivzi Sulejmani";
- Shqyrtimi i kërkesave për subvencionim nga ana e komisionit;
- QKF, Sektori i sportit: Përgatitjet për turnirin e pingpongut, që do të zhvillohet më 15 shkurt 2016, në sallës e sporteve të kolegjit "Mehemet Akif";
- QKF, Sektori i valleve, ka filluar përgatitjet për Festivalin Ndërkombëtar të Valleve në Sakaria të Turqisë;
- Dorëzimi i materialit arkivor të gjimnazit "Sami Frashëri" në Arkivin Komunal të Prishtinës.

Rini dhe Sport:

- Hartimi i planit të veprimit rinor lokal, i cili pritet të finalizohet në gjysmën e parë të muajit shkurt 2016.

4.1.2. Buxhetin i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Kulturë:

- Është iniciuar projekti për renovimin e degëve të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" dhe ndërtimin e hapësirës shtesë në Arkivin Komunal;
- Rikonstruktive në teatrin "Dodona".

Rini dhe Sport:

- Për vitin 2015, për Sektorin e rinisë dhe sportit janë ndarë 250,000 €, prej tyre janë shpenzuar 249,243 € për subvencione të projekteve rinore dhe sportive.

4.1.3 Takimet me palë

Kulturë:

- Gjatë kësaj periudhe zyra e Sektorit të kulturës kishte vërshim të palëve, të cilët shpesh të paparalajmëruar paraqiteshin në zyrë për të marrë ndonjë informacion rreth kërkesave për subvencionim. Po ashtu, palët lajmëroheshin edhe përmes telefonit për pyetje të njëjta;
- Takime të vazhdueshme me palë, përfitues të subvencioneve, rreth raporteve narrative dhe financiare;
- Takime me institucionet vartëse të DKRS-së lidhur me planifikim e organizimit për 7-8 Marsin.
- Takime me "Save the Children", znj. Rebeka Qena, dhe me OJQ "Syri i Vizionit" lidhur me planifikimin e aktivitetit për 7 Mars – Dita e Mësuesit.

Rini dhe Sport:

• Takime me përfaqësues të OJQ-ve rinore dhe klube sportive të kryeqytetit, për të diskutuar rreth nevojave dhe kërkesave të ndryshme në fushën e sportit dhe të rinisë, ndër të tjera edhe kërkesa nga të rinjtë për mënyrën e aplikimit. Sektori i rinisë dhe sportit mbështet dhe përkrah çdo iniciativë të të rinjve të kryeqytetit, duke u bazuar gjithnjë në politikat programore të Sektorit dhe në mundësitë buxhetore që posedon ky sektor.

5. Takimet me institucione të tjera

Kulturë:

- Pjesëmarrje në Seminarin për barazi gjinore;
- Takim me Komunën e Fushë-Kosovës, për bashkëpunime mes komunitetit ashkali;
- Takime me përfaqësuesit e OJQ "Anza e Ashkalinjve";
- Komunikim me Qendrën e Fëmijëve për bashkëpunim me rastin e Ditës së Pavarësisë;
- Biseda për sjelljen e një shfaqje mysafire nga Skënderaj;
- Takime me përfaqësuesin nga Ambasada franceze.

6. Diskutime Publike / takimet me qytetarë

Kulturë:

- Takime me institucionet e pavarura kulturore dhe festivale, që janë të Prishtinës, të cilat kanë qenë të qëndrueshme gjatë viteve të mëparshme.

Rini dhe Sport:

- Pas takimeve me disa përfaqësues të OJQ-ve, të njëjtit janë njoftuar që me hartimin e Planit të veprimit rinor lokal do të bëhet thirrja publike për aplikim

me projekte rinore. Ata u njoftuan që përzgjedhja e projekteve do të bëhet në bazë të kriterëve që do të caktohen nga DKRS-ja.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Kulturë, Rini dhe Sport:

- Nuk ka pasur kërkesa të tilla.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Kulturë:

- Janë pranuar dhe regjistruar gjithsej 159 kërkesa të fazës së tretë për vitin 2015, dhe Komisioni për përzgjedhjen e projekteve ka përfunduar shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre. Jemi në pritje të listës përfundimtare dhe njoftimit për kërkesat e miratuara dhe të refuzuara nga komisioni vlerësues;
- Gjatë muajit janar 2016 janë pranuar dhe regjistruar gjithsej 19 kërkesa të reja për subvencionim;
- Janë kompletuar dhe përgatitur konstatimet për pjesëmarrësit në festën e 28 Nëntorit.

Rini dhe Sport:

- Gjatë muajit janar janë pranuar 16 lëndë, prej të cilave 15 kanë qenë kërkesa nga klubet dhe shoqatat sportive dhe 1 nga OJQ rinore.

7. Takime të tjera

Kulturë:

- Kontakte me të gjitha ambasadat që punojnë në Prishtinë, gjegjësisht me përgjegjësit për kulturë;
- Takime me përfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, DKRS-në dhe punëkryesin "Diamant Kabashi", IDN menaxher i projekteve NNP "Proart" për rikonstruktimin dhe klimatizimin në teatrin "Dodona".

8. SFIDAT

Kulturë:

- Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për subvencionim ka shkaktuar shumë pakënaqësi të palët, duke shtuar fluksin e vizitave në zyrën e Sektorit të kulturës, e që shpesh ndikonte në ndërprerjen e procesit të punës.

- Sfidë në teatrin “Dodona” është nevoja për mjete, që ta shtojmë prodhimin me shfaqje të reja, rikthimin e shfaqjeve të vjetra të suksesshme, si dhe mbështetjen e udhëtimeve, që shfaqjet që kanë vlerë, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur, të jepen jo vetëm jashtë Prishtinës, po edhe jashtë Kosovës;
- Sfida më e madhe është ajo që po e përcjell me vite bibliotekën dhe që ndikon në realizimin e objektivave, është hapësira e pamjaftueshme për vendosjen e librave të reja që do të shfrytëzoheshin nga lexuesit;
- Mungesa e hapësirës në bibliotekë - salla të leximit për studentë;
- Mungesa e hapësirës për shërbime të reja inventive në bibliotekë, ku do të inkuadrohej komuniteti dhe do të rritej interesimi për librin dhe leximin, dhe biblioteka do të ishte qendër kulturore e komunitetit për mësim gjatë gjithë jetës.

Kulturë, Rini dhe Sport:

- Drejtoria jonë vazhdimisht hasë në vështirësi gjatë procedurave të pagesave të lëndëve/projekteve të subvencionuara, konkretisht në zyrën e financave, andaj për t’i evituar këto vështirësi dhe kontaktet me zyrtarët financiarë, propozojmë që tash e tutje çdo pagesë e lëndëve të DKRS-ës të bëhet përmes zyrës pritëse, ose të angazhohet një punëtor administrativo-teknik dhe financiar.

9. REKOMANDIME

Kulturë:

- Angazhim maksimal për fillimin e punës në objektin e ri të Bibliotekës;
- Trajnime të stafit të bibliotekës për organizimin e fondit dhe hapësirave në objektin e ri dhe njohuri për shërbime të reja;
- Të bëhet furnizimi shtesë me pajisje dhe materiale në institucionet varëse të DKRS së.

Rini dhe Sport:

- Krijimi i mundësive për shkëmbim të përvojave të punës me vendet në rajon, lidhur me strategjinë e sportit dhe rinisë;
- Përmirësimi i kushteve të punës në hapësirat (zyrën) ku punojmë, p.sh. pajisja me një fotokopje dhe skaner, të cilën do të mund ta shfrytëzojmë bashkërisht zyrtarët e Sektorit për rini dhe sport (pasi që të gjitha veprimet në të njëjtën zyrë).

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Kulturë:

- Konkursi për pranimin e kërkesave për subvencionim;
- Përgatitjet e QKF-së për shënimin e festës së Pavarësisë nga të gjitha seksionet: vallet, kori, solistët, instrumentistët, ambasadorët dhe Sektori i sportit, në teatrin “Dodona”, më 17 shkurt 2016;
- Finalizimi i dokumentacionit për tenderë për vitin 2016;
- Aktivitete të Bibliotekës në Ditën e Pavarësisë së Kosovës;
- Përmirësimi i dizajnit të ueb-faqes së Bibliotekës <http://www.biblioteka-pr.org/> ;
- Aktivitete të Bibliotekës, në bashkëpunim me Këndin Amerikan në degën “Përkujtimore”;
- Aktivitete me fëmijë në degën “Përrallat”;
- Në Teatrin e Kukullave “Dodona”, planifikohen 2 shfaqje premierë: “Fustani pika-pika”, për fëmijë, dhe “Më fol për dashurinë”, për të rritur;
- Shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave;
- Shfaqje të rregullta nga Skena e mbrëmjes;
- Reprizë e shfaqjes “Libri shumëngjyrësh” me rastin e Ditës së Pavarësisë - 17 shkurt 2016;
- Shfaqje të organizuar nga trupa mysafire: 2 repriza të shfaqjes “Gjyshi im është kuller” (Skënderaj); 1 program rasti (Qendra e Fëmijëve Prishtinë) me rastin e Ditës së Pavarësisë, më 17 shkurt 2016, në orën 13:00;
- Audicioni për programin “Gjeniu i vogël”, më 7 shkurt 2016;
- Provat e përditshme për premierat e reja;
- Aktivitete të përditshme për 30-vjetorin e Teatrit dhe Festivalin VI të Teatrove të Kukullave 2016;
- Vazhdimi i takimeve me institucionet dhe organizatat lidhur me organizimin e shënimit të 7 Marsit dhe 8 Marsit.

Rini dhe Sport:

- Pjesëmarrje në Seminarin lansues, të organizuar nga “Sport4All”, e cila do të mbahet më 11 shkurt 2016;
- Pjesëmarrje në inaugurimin e lokaleve të reja të Aleancës Franceze në Prishtinë, që do të mbahet më 11 shkurt 2016;
- Takim i planifikuar me “General Managment Consultants”, e cila ofron shërbime të konsulencës për Sektorin publik dhe privat me fokus në ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme të menaxhimit dhe forcimin e kapaciteteve.